

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
NALU TAXI Shpk**

Sot më datë **08.09.2025** në Tiranë, personat me të dhënat si me poshtë:

Z. Astrit Ago, shtetas shqiptar madhor dhe me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 037306379 dhe me numër personal H30730166E, lindur më 30.07.1973, në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Njesia bashkiake Nr. 2 Rruga Ali Visha, Nr.5, Tirane, më poshtë referuar si themelues,

Z. Klajdi Dhrami, shtetas shqiptar madhor dhe me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 037848374 dhe me numër personal J41221058S, lindur më 21.12.1994, në Tiranë, Shqipëri dhe banues ne Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga 4 Dëshmorët, Nr 36, Tiranë, më poshtë referuar si themelues,

Z. Dritan Sallaku, shtetas shqiptar madhor dhe me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 034659150 dhe me numër personal H70509046M, lindur më 09.05.1977, në Tiranë, Shqipëri dhe banues ne Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga Haxhi Kika, Pallati 141, Shkalla 1, apartamenti nr.8, Tiranë, më poshtë referuar si themelues,
referuar ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE" i ndryshuar; ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT" i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, vendosën të themelojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar **NALU TAXI Shpk** dhe vendosën të aprovojnë këtë Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqërisë sipas termave dhe kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Emri i shoqërisë

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, themelohet shoqëria **NALU TAXI** shpk në vijim e referuar si "shoqëria". NALU TAXI shpk është një shoqëri me formë ligjore "Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar".

Neni 2

Selia, zyra qendrore e shoqërisë

Shoqëria ka selinë e zyrës qendrore të saj në adresën: Rruga Haxhi Kika, Pallati 141, Shkalla 1, apartamenti nr.8, Tiranë, Shqipëri.

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve

dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë, që kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të papërcaktuar.

Neni 4

Objekti i shoqërisë

Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohet me ligj.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është si më poshtë:

“Shërbime në fushën e transportit të udhëtareve. Shërbime taksi për publikun si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj. Transporti urban dhe interurban në funksion të shërbimit taksi të udhëtarëve, në përputhje me çdo ligj të zbatueshëm dhe rregulloreve të fushës përkatëse. Tregëti dhe dhënie me qira e makinave, motorëve, minibus, autobus, jahte, mjete lundruese, etj, si dhe të gjitha llojeve të tjera të mjeteve motorike, personave të tretë. Tregëtim, shërbim me qera, me drejtues mjeti, për çdo mjet të lëvizshëm të lejuar për qarkullim, shërbim taksi, shërbim urban, ndërurban, ndërkombëtar, ndërkontinental, etj. Krijimi i agjensive turistike, organizimi i guidave turistike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Transport udhëtarësh e mallrash, kombëtar e ndërkombëtar, cargo, etj. Kryerja e shërbimeve postare të llojeve të ndryshme, dërgesave postare si: zarfe, dokumenta ose ngarkesa të ndryshme nëpërmjet tokës, detit dhe ajrit, në Shqipëri dhe jashtë saj”.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë dhe kontributi për të është në para. Numri i përgjithshëm i kuota të shoqërisë është 3 (tre) kuota. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Në rastin e kalimit të kuotave nevojitet miratimi i shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë apo zvogëlojë kapitalin e shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në çdo rast, kapitali nuk mund të reduktohet nën vlerën minimale të përcaktuar me ligj.

Neni 6

Ortakët e shoqërisë

Kuota e shoqërisë zotërohen nga ortakët si më poshtë:

1. **Z. Astrit Ago**, me numër personal H30730166E, zotërues i 1 (një) kuote, me pjesëmarrje 33,33 (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) % (përqind), me vlerë kapitali 33,33 (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë.

2. **Z. Dritan Sallaku**, me numër personal H70509046M, zotërues i 1 (një) kuote, me pjesëmarrje 33,33 (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) % (përqind), me vlerë kapitali 33,33 (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë.

3. **Z. Klajdi Dhrami**, me numër personal J41221058S, zotërues i 1 (një) kuote, me pjesëmarrje 33,34 (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katërt) % (përqind), me vlerë kapitali 33,34 (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katërt) lekë.

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara. Ortaku mund të largohet nga shoqëria duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Asambleja e përgjithshme

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 70 për qind të kuotave. Asambleja e përgjithshme vepron në përputhje me legjislacioni në fuqi.

Neni 8

Përfaqësuesi ligjor

Përfaqësues ligjor i shoqërisë emërohet Znj.Ina Nuellari, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtjese i kartës së identitetit me numër 037870236 dhe me numër personal J55102057N, lindur më 02.01.1995, në Skrapar, Shqipëri dhe banues ne Tiranë, Shqipëri në adresën: Rruga 4 Dëshmorët, Nr 36, Tiranë.

Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Administratori kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 9

Periudha raportuese

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit që fillon nga rregjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit deri më 31 Dhjetor të tij.

Neni 10

Prishja e shoqërisë

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Administratori regjistron prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Të tjera

Për çdo gjë e papërmendur në këtë akt do të respektohet legjislacioni në fuqi. Mosmarrëveshjet do të zgjidhen më mirëkuptim ndërmjet palëve, në të kundërt do ti drejtohen për zgjidhjen e tyre gjykatës kompetente.

Ky dokument është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, të barasvlefshme me njëra-tjetrën.

ORTAKËT E SHOQËRISË

NALU TAXI SHPK

Z. Astrit Ago

ASTRIT AGO


Z. Dritan Sallaku

DRIATAN SALLAKU


Z. Klajdi Dhrami

KLAJDI DHRAMI
